



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr.

6823

Data: 22.08.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË PALDENICË PËR DRAFT
BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i tretë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **11.08.2025**, duke filluar nga ora **19:00** në SHFMU “**Kështjella e Diturisë**” - **Paldenicë**, me gjithsej 8 pjesëmarrës/e, prej tyre 2 gra dhe 6 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z.Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi thekson: Sot jemi në fshatin Paldenicë, ku do të prezentohet Draft Buxheti i vitit 2026 dhe parashikimet e hershme të vitit 2027-2028. Besoj se administratori i fshatit s’paku mundet me i nxit banorët me bo kërkesa, qoftë edhe me shkrim ashtu siç i keni bo herën e fundit, ose kërkesa me mesazh ose drejtëprdrejt te Qendra për Shërbim me qytetarët, ne i përfshijmë në Draft Buxhet dhe pastaj mbetet tek Kuvendi për miratim të projekteve, që zakonisht edhe janë miratu. Ka projekte që janë kërku, por që kanë qenë për shumë lokacione dhe ato janë përfshirë në emërtim, shembull ku e kemi projektin për kanalizimet, shtrirja e ndriçimit publik, zgjerimi i rrugëve, ku kemi gjeneralizu Hanin e Elezit dhe fshatrat përreth, pra sipas nevojës se ku do të ketë hapësirë. Për fshatin Paldenicë, projekte të tilla kemi tek rregullimi i kanalizimeve, ndriçimi publik, riparimi i trotuareve dhe rrugëve, rregullimi i krojeve publike, rregullimi i përrockave dhe kanalizimeve atmosferike, shenjëzimi i pikave turistike, ndërtimi i mureve mbrojtëse, shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve, ndërtimi zgjerimi dhe rihapja e rrugëve, ndërtimi dhe rregullimi i këndëve të lojërave, rregullimi i infrastrukturës shkollore, dhe renovimi i sallave sportive në shkolla, etj. Ndërsa për prezentimin në pika të shkurta mbi ndarjet buxhetore besoj se drejtoresha do të japë sqarimet e nevojshme.

fshatin Pustenik dhe Laçt përfshihen në zonën kadastrale të Pustenikut. Deh atë ujë është mirë me e përpunu se sa me e lanë me shku kot.

Sadam Dernjani: Ne kemi dërgu kërkesa në komunë të cilat për shkak të buxhetit kanë ngecë, zakonisht kontataktet i kemi mbajtur me Zyrën e Urbanizmit. Tash a duhet me i ripërsërit qato kërkesa?

Mehmet Ballazhi: Kërkesat janë, veç presim me i gjet mënyrat e financimit të tyre.

Abdurraman Bushi: Te lagjja e Ujit të Thartë, te familja e Tefik e Halit Bushit, është një rrugë diku më pask se 100 metra që duhet me u shtru me kocka, kjo ka qenë kërkesë e Halit Bushit një ditë në komunë sa ishte, ata janë të gatshëm me e shpronësu atë pjesë, dmth me e bo atë pronë publike edhe me e lëshu për rrugë me u asfaltu ose me kocka.

Mehmet Ballazhi: Do të ishte mirë që ata dy vëllezërit me e bo një kërkesë me shkrim te komuna, me e dhanë naj deklaratë me shkrim që e lëshojnë atë pronë edhe do të shohim mundësinë që edhe sivjet me e shtru meqë edhe distanca e rrugës s'qenka e madhe, po nëse jo sivjet, mundet edhe vitin e ardhshëm.

Mehmet Ballazhi: Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 19:25.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

